



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 11.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Spin Agency" për aktivitetin: "Implementimi i platformës E-shkollori" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-6478-221 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Spin Agency" e datës 09.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit : "Implementimi i platformës E-shkollori" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-6478-221.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj tutje me *kete aktivitet sipas publikimit te dates 02.11.2020*

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Spin Agency" me datë 06.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Implementimi i platformës E-shkollori" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-6478-221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.11.2020, pas konsultimeve të gjata me njohesit e teknologjise informative dhe të shërbimeve të kerkuara, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE-ik"Spin Agency" lidhur me aktivitetin e prokurimit: Implementimi i platformës E-shkollori" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-6478-221.

-Pretendimet tuaja qe kundërshtojne arsyet e anulimit te aktivitetit janë te pa bazuara, pasi qe te gjithë njohësit e kësaj lëmie konsiderojnë se te njëjtat janë te domosdoshme per zbatimin profesional te këtij aktiviteti.

Bazuar ne sqarimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit